

● **Pse është i nevojshëm ky libër shoqërues i emisioneve radiofonike?**

Ky është libri shoqërues i Pjesës së Tretë të kursit të gjermanishtes në radio “*Deutsch – warum nicht?*” Ashtu si dy librat shoqërues të Pjesës së Parë dhe Pjesës së Dytë, edhe ky libër është hartuar kryesisht si shoqërues i emisioneve radiofonike.

Dëshirojmë t’ju rekomandojmë që gjithmonë të dëgjoni transmetimin në radio, kjo është edhe mënyra më e mirë për të mbajtur mend një situatë të caktuar. Për t’ju ndihmuar ne kemi përgatitur në çdo mësim ushtrime dëgjimi. Ato e përqendrojnë vëmendjen tuaj në thelbësoren, domethënë ndihmojnë që t’ju fiksohen në kujtesë situata në të cilën zhvillohet ngjarja, kush flet dhe me kë flet, për çfarë bisedojnë personazhet dhe se në çfarë gjendjeje shpirtërore janë ata. Përpikuni të përqëndroheni në këto çështje dhe kini parasysh se nuk është e nevojshme t’i kuptoni fjalë për fjalë ato që dëgjoni.

● **Ç’është e re në Pjesën e Tretë?**

Personazhet kryesore të Pjesëve I dhe II i takoni edhe në Pjesën III:

- **Andrea**, Andrea është student dhe punon si sportelist/receptionist në hotelin “Evropa”.
- **Ex**, Eksa është një personazh femëror imagjinar – e padukshme, por që na bën ta ndiejmë shpesh praninë e saj. Ajo u zhduk në fund të Pjesës së Dytë, por tani shfaqet prapë. Personazhet e tjerë të kursit tashmë janë mësuar me Eksën dhe me vërejtjet e saj ...
- **Dr. Thürmann**, Dr. Tyrmani është një klient i rregullt i hotelit “Evropa”. Ai jeton në Berlin.
- **Frau Berger**, Zonja Berger është drejtoresha e hotelit “Evropa”.
- **Hanna Clasen**, Hana Klazen është punëtore e pastrimit në hotelin “Evropa”.

Struktura e mësimëve në Pjesën e Tretë është e njëjtë me strukturën e dy Pjesëve të para: së pari dëgjoni tekstin, pastaj vijnë shpjegimet për të. Kjo ndiqet nga shpjegimet për strukturat gramatikore dhe në fund vjen përsëritja e tekstit. Tekstet në Pjesën e Tretë janë pak më të vështira se në dy Pjesët e para. Ngjarjet në Pjesën e Parë dhe të Dytë të kursit zhvilloheshin në Ahen, ndërsa në gjysmën e dytë të Pjesës së Tretë ato zhvillohen në **Berlin**. Mësimet përmbajnë informacion për këtë qytet, për historinë e tij. Tregimet për Berlinin ju japin një përshtypje për jetën në kryeqytetin e ri të Gjermanisë.

Në fillim të Pjesës së Tretë bëhet përsëri paraqitja e personazheve kryesore dhe e strukturave kryesore gramatikore. Kështu që do të keni mundësinë t’i ndiqni mësimet e reja edhe sikur të mos na keni ndjekur në dy Pjesët e para.

● Përmbajtja e këtij libri shoqërues

A Të dhëna për historinë e Republikës Federale të Gjermanisë dhe për Berlinin.

Kjo përmbledhje e shkurtër është një informacion bazë për sfondin historik të ngjarjeve në Gjermaninë Perëndimore dhe Lindore, në periudhën 1945-1990. Gjermania në këtë kohë ka qenë e ndarë në Republikën Federale të Gjermanisë = RFGJ (ose BRD në gjermanisht) dhe në Republikën Demokratike Gjermane = RDGJ (ose DDR në gjermanisht).

B Të dhëna për mësimet e ndryshme

1. Një përmbledhje e gramatikës

Këtu janë përmbledhur çështjet kryesore gramatikore (= **Çfarë duhet të dini**) dhe shprehjet e rëndësishme (= **Shprehje të dialogëve**) të çdo mësimi. Në dallim nga Pjesët I dhe II, shprehjet tani paraqiten vetëm gjermanisht. Kudo që ka qenë e mundur, ato janë dhënë në formën që dalin në mësim, si dhe në formën përfaqësuese me të cilën mund t'i gjeni në fjalor.

Shembull

Fjalja *Sie singt gern* jepet edhe në formën e paskajores (infinitivit) *etwas gern tun*. Kjo ju jep mundësi të formoni shprehje të tjera me të njëjtën idiomë, p.sh.: *Er liest gern*.

Nëse kuptimi i ndonjë shprehjeje nuk del për ju i qartë, mund të shikoni përkthimet e dialogëve në fund të librit. Mësimet për Berlinin përmbajnë edhe informacion të veçantë rreth qytetit dhe kuriozitetet turistike të tij.

2. Tekstet e çdo mësimi

Tekstet (dialogët, shpjegimet, letrat, këngët) do t'i gjeni në gjermanisht pas përmbledhjes së gramatikës dhe të shprehjeve idiomatike. Për ta lehtësuar kuptimin e tyre, ato paraqiten në formë përmbledhjeje edhe në shqip. Pra, nëse një herë nuk e ndiqni transmetimin e mësimin në radio, mësimin mund ta lexoni në libër.

3. Fjalë dhe shprehje

Fjalët dhe shprehjet që i ndeshni për herë të parë janë shënuar në fund të çdo dialogu. Leksiku i fragmenteve origjinale, siç është p.sh. një tekst i Bertolt Brehtit, nuk është shënuar. Fjalët dhe shprehjet që ndeshen në Pjesën e Parë dhe të Dytë këtu nuk përsëriten.

4. Ushtrime

Shumica e ushtrimeve trajtojnë çështje gramatikore, por do të gjeni edhe ushtrime për leksikun, siç janë p.sh. fjalëkryqet dhe ushtrimet për përdorimin e saktë të fjalëve dhe shprehjeve. Pjesa e Tretë përmban edhe ushtrime kuptimi, me anë të të cilave synohet të provohet sa e keni kuptuar tekstin.

P.sh. ju jepet një listë shprehjesh dhe fjalish dhe ju kërkohet të gjeni prej tyre atë fjali që në dialogun radiofonik ka shërbyer si përgjigje. Në rast nevojë mund t'u referoheni dialogëve që janë dhënë të plotë në çdo mësim. Nganjëherë prej jush kërkohet shprehimisht që t'u referoheni dialogëve. Përgjigjet për pjesën më të madhe të ushtrimeve mund të gjenden në çelësin e ushtrimeve në fund të librit. Kur janë të mundura disa përgjigje, sugjerimet janë shënuar tek çelësi i ushtrimeve me**. Zgjidhjet për ushtrimet që nuk kërkojnë një zgjidhje të caktuar nuk janë përfshirë në çelës.

C Përmbledhje e gramatikës

Këtu janë paraqitur çështjet e reja gramatikore që hasen në Pjesën e Tretë. Gramatika në Pjesën e Tretë përfshin:

1. Imperfektin e foljeve të rregullta dhe të parregullta si dhe të foljeve modale.
2. Lidhëzat
Lidhëzat bashkërenditëse që përdoren për të lidhur pjesë kryesore të fjalisë, p.sh. *und, aber, sondern* Lidhëzat që përdoren për të lidhur pjesën kryesore me pjesën e varur të fjalisë, p.sh. *daß, weil*
3. Lakimin e mbiemrave

D Çelësi i ushtrimeve

Çelësin e ushtrimeve mund ta përdorni për të kontrolluar nëse i keni zgjidhur drejt ushtrimet e çdo mësimi.

E Përkthimi i dialogëve

Përkthimi i dialogëve synon të ndihmojë për të rrokur kuptimin, sidomos në ato raste kur nuk keni ndjekur Pjesën e Parë dhe të Dytë të kursit dhe nuk jeni ambjentuar me fjalorin dhe gramatikën e paraqitur. Tekstet origjinale të këngëve dhe vjershave nuk janë përkthyer për arsye të mbrojtjes të së drejtës së autorit.

F Fjalori alfabetik

Fjalori alfabetik përmban fjalët e reja të Pjesës së Tretë. Fjalët e Pjesës së Parë dhe të Dytë këtu nuk përsëriten. Pas çdo fjale jepet në kllapa numri i mësimit ku fjala ndeshet për herë të parë.

G Lista e foljeve: Paskajorja – Imperfektin – Pjesorja e shkuar

Kjo listë përmban të gjitha foljet që janë hasur në Pjesën e Parë, të Dytë dhe të Tretë të kursit të gjuhës. Paskajorja, imperfektin dhe pjesorja e shkuar e foljeve janë dhënë në çdo rast që ju të keni mundësi të formoni kohët më të rëndësishme.

Shembull: *kommen – kam – gekommen <sein>*

Paskajorja: *kommen*

Imperfektin: *(er/sie) kam*

Pjesore e shkuar: *gekommen*

Folja *sein* vendoset në kllapa për të treguar se folja *kommen* e formon kohën e kryer me foljen ndihmëse *sein*.

Er ist gekommen.

Ashtu siç ndoshta e dini, ky kurs gjuhe transmetohet në të gjithë botën, në një numër të madh gjuhësh. Për këtë arsye nuk ka qenë e mundur që të merren parasysh veçoritë specifike të vendit tuaj, të kulturës dhe të gjuhës suaj. Por ne shpresojmë se ju do të jeni në gjendje t'i vini re ndryshimet dhe ngjashmëritë midis gjermanishtes dhe shqipes. Nuk na mbetet gjë tjetër veç urimit:

Punë të mbarë dhe suksese në mësimin e gjermanishtes me
Deutsch – warum nicht?

Herrad Meese

Disa të dhëna

I Nga historia e Gjermanisë

Materiali i mëposhtëm është një pasqyrë e shkurtër e historisë së Gjermanisë. Është hartuar për të dhënë një informacion bazë për disa periudha të historisë së këtij vendi, që ju të kuptoni më mirë disa nga mësimet e Pjesës së Tretë të këtij kursi. Përzgjedhja e ngjarjeve është bërë duke e vënë theksin në ato ngjarje që kanë çuar në krijimin e identitetit kombëtar gjerman.

919: Fillimi i historisë gjermane, Perandoria e Parë Gjermane

Deri në shekullin e 19-të: Copëtimi, ndarja e Gjermanisë në shtete të vegjël.

Deri në shekullin e 19-të Gjermania përbëhej nga shumë shtete të vegjël – principata, dukata dhe mbretëri. Sunduesit e këtyre shteteve të shumta sovraane kishin pushtet të madh në territoret e tyre. Kjo ndarje e Gjermanisë në shtete të vogla vazhdoi deri në fillim të shekullit të 19-të. Vetëm në fillim të shekullit të 19-të fillon të ndihet nevoja për të pasur një identitet kombëtar.

1871–1918: Perandoria e Dytë Gjermane

1870/71: Lufta Franko – Prusiane

1871: Themelimi i Perandorisë së Dytë Gjermane në Pallatin e Versajës. Vilhelmi I bëhet perandor i Gjermanisë; Berlini bëhet kryeqytet.

1918: Fundi i Luftës së Parë Botërore

1919–1933: Republika e Vajmarit

1919: Kushtetuta e Vajmarit

1919: Nënshkrimi i Traktatit të Paqes së Versajës

1933–1945: Nationalsocializmi /(Perandoria) Rajhu i Tretë

1933: Adolf Hitler emërohet kancelar i Gjermanisë

1939: Gjermania sulmon dhe pushton Poloninë; Fillimi i Luftës së Dytë Botërore

1945: Kapitullimi i Gjermanisë; fundi i Luftës së Dytë Botërore. Aleatët – SHBA, Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Franca – e ndajnë Gjermaninë në katër zona pushtimi.

1949–1990: Gjermania është e ndarë në dy shtete gjermane: Republika Federale e Gjermanisë (RFGJ = BRD) dhe Republika Demokratike e Gjermanisë (RDGJ = DDR)

1949: Themelimi i Republikës Federale Gjermane me kryeqytet Bonin; RFGJ hyn në Nato.

1949: Themelimi i Republikës Demokratike Gjermane me kryeqytet Berlinin e Lindjes; RDGJ hyn në Traktatin e Varshavës.

Që prej kësaj kohe Gjermania ishte e ndarë (siç ishte edhe qyteti i Berlinit). Fillimisht, gjermanoperëndimorët nuk lejoheshin ta vizitonin RDGJ. Po kështu, ishte praktikisht e pamundur që shtetasit gjermanolindorë të emigronin në Republikën Federale të Gjermanisë, nëqoftëse nuk kishin moshën e pensionit. Midis viteve 1945–1957, 2,7 milionë njerëz (ose 15% e popullsisë së RDGJ) ikën në Gjermaninë Perëndimore. Shumë prej tyre ishin specialistë të fushave të ndryshme. Që prej vitit 1961, kufiri midis Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore u fortifikua dhe ruhej rreptësisht; rojet gjermanolindore të kufirit kishin urdhër të shtinin me armë kundër kujtdo që përpiqej të arratisej. Në të njëjtin vit u ndërtua Muri i Berlinit, që ndante Lindjen nga Perëndimi i qytetit.

3.10.1990: RFGj dhe RDGJ bashkohen

Që prej kësaj kohe, Gjermania është shtet i bashkuar. Berlini është kryeqytet, ndërsa Boni është rezidencë e qeverisë për një periudhë tranzitore.

2 Historia e Berlinit

- 1470: Berlino bëhet rezidenca e Princit të Zgjedhur të Brandenburgut.
 1709: Berlino bëhet kryeqytet i mbretërisë së Prusisë.
 1871: Berlino bëhet kryeqytet i Perandorisë Gjermane.
 1939: Fillimi i Luftës së Dytë Botërore.
 1945: Fundi i Luftës së Dytë Botërore.
 Berlino administrohet nga "Katër Fuqitë" (Britania e Madhe, Franca, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik).
 1946: Zgjedhje të lira në gjithë Berlinin.

Berlino – një qytet i ndarë prej 1948–1989

- 1948: Berlino ndahet në Berlin Lindor dhe Berlin Perëndimor.
 1948/49: Bllokada e Berlinit.
 Sovjetikët mbyllin të gjitha rrugët për në Berlin dhe ndalojnë të gjitha furnizimet për këtë qytet. Për një vit të tërë amerikanët organizojnë një urë ajrore për të furnizuar Berlinin me ushqime dhe pajisje: gjithçka transportohet në Berlin me avionë.
 1953: Kryengritje në Berlin kundër regjimit të Gjermanisë Lindore.
 1958: Hrushovi njofton Marrëveshjen e Katër Fuqive dhe kërkon që Berlino perëndimor të bëhet "qytet i hapur".
 1961: Ngrihet Muri i Berlinit, i cili e ndan qytetin në dy pjesë. Berlinezët perëndimorë nuk kanë më mundësi të kalojnë në Berlinin Lindor. Gjatë gjithë murit është një zone kufitare e gjerë, e cila ruhet me rreptësi. Rojet kufitare gjermanolindore kanë të drejtë të shtijnë me armë ndaj kujtdo që përpiqet të arratiset në Gjermaninë Perëndimore.
 1963: Marrëveshja e parë për tranzitin e pasagjerëve: berlinezet perëndimorë lejohen të vizitojnë të afërmit e tyre në Berlinin Lindor çdo fund viti.
 1968: Gjermanoperëndimorët duhet të pajisen me pasaporta për të udhëtuar për në Berlinin Lindor dhe me vizë për të hyrë në Gjermaninë Lindore.
 1989: Muri i Berlinit bie, hapet Porta e Brandenburgut. Berlinezët lindorë dhe perëndimorë mund të lëvizin përsëri lirisht në gjithë qytetin.
 1990: Muri i Berlinit shkatërrohet.



Berlin



Copyright © by

Kartographischer Verlag

D-63170 Oberhausen bei Frankfurt am Main
P. O. Box 2105 · Tel. (061 04) 7 90 39 · Fax (061 04) 7 53 56



4 Muajt e vitit

1	Januar	janar	7	Juli	korrik
2	Februar	shkurt	8	August	gusht
3	März	mars	9	September	shtator
4	April	prill	10	Oktober	tetor
5	Mai	maj	11	November	nëntor
6	Juni	qershor	12	Dezember	dhjetor

Wann kommen Sie? Im Januar.

5 Anët e horizontit

der Norden / Veriu
nördlich / verior

Der Westen / Perëndimi
westlich / perëndimor



Der Osten/Lindja
östlich / lindor

Der Süden / Jugu
südlich / jugor

Wo liegt Aachen? Aachen liegt im Westen (von Deutschland).
Wo liegt Köln? Köln liegt nördlich von Bonn.
Köln liegt nordöstlich von Aachen.

Man ging durch das Brandenburger Tor von Osten nach Westen.
Berlin kann eine Brücke zum Osten werden.

6 Numrat nga 100 deri në 1 000

100 = hundert	500 = fünfhundert	800 = achthundert
200 = zweihundert	600 = sechshundert	900 = neunhundert
300 = dreihundert	700 = siebenhundert	1000 = tausend
400 = vierhundert		

101 = einhunderteins 202 = zweihundertzwei 311 = dreihundertelf
420 = vierhundertzwanzig 435 = vierhundertfünfunddreißig

100. = **emërore:** Das ist der hundertste Geburtstag,
das ist die hundertste Frage,
das ist das hundertste Buch.
kallëzore: Er hat den hundertsten Geburtstag,
er stellt die hundertste Frage,
er kauft das hundertste Buch.

7 Vitet

Numri i parë, ose dy numrat e para tregojnë shekullin. Kur thoni vitin, ju shtoni fjalën njëqind (*bundert*) pas këtyre numrave.

911 = neunhundertelf
1871 = achtzehnhunderteinundsiebzig
1961 = neunzehnhunderteinundsechzig
1990 = neunzehnhundertneunzig